



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO	
KOMUNA E VUSHTRISË-OPŠTINA VUČITRN	
01 Nr. / Br	45/17
Nr. i fq. / Br. st	- 13 -
Data: / Datum	23. 02. 2017
VUSHTRRİ - VUČITRN	



REPUBLIKA E KOSOVËS

KUVENDI I KOMUNËS-VUSHTRRI

**PROCESVERBAL  
NGA MBLEDHJA E -I- (E PARË) E RREGULLT E KUVENDIT TË KOMUNËS SË  
VUSHTRISË, MBAJTUR MË 26 JANAR 2017**

*Mbledhja është mbajtur në sallën e Kuvendit Komunal, duke filluar në orën 10:10.*

Në këtë mbledhje ishin të pranishëm anëtarët e Kuvendit të Komunës në Vushtri:

Adnan Klinaku, Agim Bregaj, Agron Përçuku, Ali Januzi, Arta Ismajli, Bahrije Pllana, Ergin Sunguri, Fakete Dushi, Habib Mustafa, Habibe Gërxhaliu, Hysni Gërguri, Ilmi Azemi, Isa Haxhiqi, Mehmet Selaci, Mejreme Ismajli, Melihate Basholli, Mentor Ferizi, Mirjeta Salihu, Muhamet Shabani, Myrvete Hetemi, Qerim Selimi, Rrahim Ajeti, Sabri Ferati, Safet Idrizi, Safet Osmani, Selim Rustemi, Selvete Sholla, Syzana Syla, Shaban Beka, Shkelzen Feka, Shpëtim Zhegrovë, Tasim Gubetini, Xhevahire Selmani dhe Zoran Rakiç.

**Mungoi: Finesë Haxhiqi-Cakoli.**

Të pranishëm në këtë mbledhje ishin edhe kryetari i komunës, nënkyetari i komunës, përfaqësuesi i KFOR-it, përfaqësuesi i OSBE-së dhe përfaqësues të shoqërisë civile.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi Shpëtim Zhegrovë – kryesues i kuvendit, i cili vërtetoi se ka shumicë për punë dhe hapi debatin për rendin e ditës.

**Shpëtim Zhegrovë, kryesues i kuvendit** – njoftoi se procesverbali i mbledhjes së kaluar i kuvendit, është dërguar përmes emil-adresës, përfaktin se aparati fotokopjues kishte qenë në defekt dhe ky material, nuk kishte mundur të dërgohet në kopje fizike. Në vazhdim në kuadër të debatit për rendin e ditës propozoi 3 pika shtesë në pikën në të ndryshme që të futen në rend të ditës për shqyrtim dhe aprovim.

**Shkelzen Feka, anëtar i kuvendit** – paraqiti vërejtjet e tij sa i përket dërgimit të materialeve të kuvendit, përfaktin se kërkoi që të respektohet afati që materiali i kuvendit të dërgohet shtatë ditë pune para mbajtjes së mbledhjes së kuvendit afat ky që buron nga Rregullorja e Punës së Kuvendit.

**Hysni Gërguri, anëtar i kuvendit** – paraqiti vërejtjet e tij sa i përket dërgimit të procesverbalit të mbledhjes së kaluar të kuvendit dhe shtoi se arsyetimi se nuk ka punuar aparati i fotokopjimit nuk është i qëndrueshëm dhe i logjikshëm. Pastaj pyeti se përsë nuk është dërguar procesverbal i mbledhjes së jashtëzakonshme.

*Në përfundim të diskutimeve rreth rendit të ditës, Kuvendi me vota “unanime” aprovoi këtë:*

## R E N D D I T E

1. Shqyrtimi dhe aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;
2. Shqyrtimi i Informatës për punën e Kuvendit të Komunës për vitin 2016;
3. Shqyrtimi i Raportit tremujor për të hyrat, shpenzimet buxhetore, si dhe realizimin e investimeve kapitale;
4. Shqyrtimi i Draft-Planit të punës së Kryetarit të komunës;
5. Shqyrtimi i Draft-Planit të punës së kuvendit për vitin 2017 (**shqyrtimi i dytë**);
6. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për aprovimin e listës së subvacioneve për vitin 2017;
7. Shqyrtimi i Informatës lidhur me implementimin e rekomandimeve të Auditorit të Përgjithshëm për pasqyrat financiare 2015;
8. Shqyrtimi i Draft-Planit të veprimit për përmirësimin e shërbimit-Mobiliteti në trafik 2017-2019 ;
9. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për ndihmë financiare nga fondi për transfere dhe subvencione;
10. Shqyrtimi i Raportit vjetor për punën e Komitetit për Komunitete;
11. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për emërimin e anëtarëve të Komitetit Konsultativ për Persona me Nevoja të Veçanta;
12. Të ndryshme.
  - a). Shqyrtimi i Propozim-vendimit, për ofrimin e ndihmës financiare për shërim për Kujtim Saracin;
  - b). Shqyrtimi i Propozim-vendimit, për ofrimin e ndihmës financiare për shërim për Veton Rrahmanin;
  - c). Shqyrtimi i Propozim-vendimit, për lejimin e mjeteve financiare nga subvencionet dhe transferet për Qendrën për Mbrojtjen e Gruas dhe Fëmijës "Raba Voca".

1. Shqyrtimi dhe aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;

*Pas shqyrtimit të kësaj pike të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit në mënyrë unanime aprovoi procesverbalin e mbledhjes paraprake të KK-së.*

2. Shqyrtimi i Informatës për punën e Kuvendit të Komunës për vitin 2016;

**Muharrem Shabani, anëtar i kuvendit** – tha se kjo informatë ka pasqyruar në tërësi punën njëvjeçare të kuvendit të komunës, dhe shtoi se nuk duhet të flasim vetëm në superlativ, por duhet të jemi edhe vetkritik në punën tonë, më qëllim që mos përsëriten gabimet apo lëshimet që janë bërë në të kaluarën dhe që të jemi më efektiv në mënyrën më të mirëfilltë t'i zbatojmë ligjet që e rregullojnë lëmin dhe kompetencën tonë. Në vazhdim ai vlerësoi se duhet të jemi më efikas në ofrimin e materialeve të kuvendit duke bërë vërejtje se shpeshherë kemi pasur vonesa në marrjen e materialit. Pastaj sugjeroi që shumë materiale duhet të kalojnë përmes Zyrës ligjore, me qëllim që kjo do të ndikonte që vendimet tona të janë ligjore, dhe mos të apelohen në instancat e pushtetit qendror. Në fund tha se duhet të kemi një angazhim më të madh të administratës në ngritjen e kualitetit të dokumentacionit, në aspektin sintaksor dhe morfoligjik të dokumenteve që vinë në kuvend për shqyrtim dhe aprovim.

3. Shqyrtimi i Raportit tremujor për të hyrat, shpenzimet buxhetore, si dhe realizimin e investimeve kapitale;

**Mehmet Selaci, anëtar i kuvendit** - tha se sa i përket raportit për të hyrat dhe shpenzimet buxhetore, unë dëshiroj të ndalem veçanërisht në një çështje e kjo çështje ka të bëjë me shpenzimet për ushqime, pije dhe darka zyrtare. Për një vit, pra gjatë vitit 2016, komuna jonë

për ushqime, pije dhe darka zyrtare së bashku, i ka shpenzuar 60.062 €uro, që llogaritur ndryshe i bie rrëth 5005 €uro në muaj, apo 166 € e 83 centë në ditë. Këto shpenzime përmendimin tim janë marramendëse, duke e marrë parasysh varférinë në të cilën gjenden qytetarët e komunës sonë. Komuna jonë ndan një total prej vetëm 5000 euro në vit për të bashkëfinancuar ndërtimin e shtëpisë për personat në nevojë, kjo shumë qesharake nuk i përbush nevojat për ta ndërtuar as një gjysmë shtëpie në vit. Pra, për një vit ndahen vetëm 5000 €uro për ndërtimin e shtëpisë, kurse komunarët i hanë dhe i pinë rrëth 5005 €uro në muaj, nga paratë e taksapaguesve! A nuk ju doqet kjo absurde?! Thuhet që nuk ka para për ta paguar transportin e nxënësve që jetojnë larg shkollave të tyre, kurse për të ushqyer veten i kanë mbi 60.000 € në dispozicion, a nuk është kjo e turpshme?! Qytetarët e papunë vdesin nga uria, nga sëmundjet në pamundësi financiare për t'u shëruar, nga mungesa e gjërvave elementare, kurse komunarët që kanë paga të konsiderueshme, të cilat siç duket nuk iu mjaftojnë, i shpenzojnë mesatarisht 166 euro në ditë nga buxheti i komunës, për ushqime dhe pije! Nëse mesatarisht një shujtë për person kushton 1 euro, i bie që nëse komunarët nuk do i hanin për vete, do të mund të ushqeheshin 166 persona të varfér me nga një shujtë për çdo dite! Me të vërtet jam thellë i indinjuar me shpenzimet enorme, siç duket ju kurrë nuk do te ngopeni, kurse shumë qytetarë do të mbesin përgjithmonë të uritur faji juaj.

**Ilmi Azemi, anëtar i kuvendit** – tha se kur flasim për raportin tremujor për të hyrat dhe shpenzimet buxhetore, pikësëpari duhet të ndalemi tek të arriturat ku tregohet një performancë e lartë në inkasimin e të hyrave vetanake kjo përfaktin se komuna për periudhën raportuese ka realizuar 84 % të shumës së planifikuar. Tuttje duke iu referuar parafolësit të tij, tha se për hir të transparencës duhet bërë e ditur se parafolësi ose nuk i kuption çështje ekonomike ose ka tendencia që të manipulojë me opinionin dhe me anëtarët e kuvendit, në të kundërtën në tabelën shpenzimet, mallrat dhe shërbimet dhe subvencionet janë në mënyrë të detajuar të precizuara në bazë të kodeve ekonomike të gjitha shpenzimet. Andaj vlera e shpenzimeve për dreka zyrtare është 13,711.023 €, dhe nuk qëndron konstatimi i parafolësit. Pastaj në kodin tjetër ekonomik “furnizim me ushqim dhe pije” ku shënon në mënyrë taksative se është fjala përfurnizime jo dreka zyrtare siç dihet se në këtë kuadër hynë çerdhja e qytetit dhe shpenzimet nga ky fond. Në vazhdim apeloi tek të gjithë anëtarët e kuvendit që edhe përkundër asaj se ky vit është vit zgjedhor të mos manipulojnë me të vërteten, mos të manipulojmë me shifra, për arsy se këto manipulime nuk do ti bënin nder as vetës së tyre dhe as subjektit të tyre politik, por thjesht do të përqesheni në qytet.

**Hysni Gërguri, anëtar i kuvendit** – paraqiti vërejtje, në titullin e këtij rapporti, duke shtuar se emërtimi i raportit është raport tremujor, kurse periudha është janar-dhjetor e që kjo nuk ka logjikë. Tuttje shtoi se donacionet e brendshme dhe të jashtme duhet të precizohen dhe të dihen me emër dhe mbiemër se kush i ka dhënë donacione komunës. Pastaj tek buxheti dhe financat, taksa në firmë është realizuar vetëm 57 %, e kjo përqindje është shumë e ulët krahasuar me tatimin në pronë, i cili është 102 %. Mandej tek lejet e ndërtimit dhe shfrytëzimi i pronës publike në Drejtorinë e Urbanizmit, pyeti se a është paraparë që të pajisen me leje edhe objektet e ndërtuara pa leje që nuk është cekur askund. Shfrytëzimi i pronës publike pyeti se cila pronë publike është shfrytëzuar dhe cila pronë ka mbetur pa u shfrytëzuar. Tek kultura, rinia dhe sporti kemi realizim të shpenzimeve prej 93 %, në krahasim me planifikimin, këtu kërkoi që të shënohet se për çfarë janë shpenzuar këto mjete. Shpenzimet përmallra, shërbime dhe subvencione, konkretisht shpenzimet për anëtarësim në vitin 2015 kanë qenë 3,229 €, ndërsa në vitin 2016 shpenzimet kanë shkuar në 15,645.00 € dhe për këtë pyeti se për çfarë anëtarësimi bëhet fjalë. Furnizimi me ushqim dhe pije (jo dreka zyrtare) 46,351.49, për këtë pyeti se çka nënkupton termi “jo dreka zyrtare”, si dhe për çka janë shpenzuar këto mjete, për të njëjtën kategori në vitin 2015 ishin shpenzuar 23,909.32 €, për këtë kërkoi sqarime se përsë ka ndodhur rritja e shpenzimeve përfshirë këtë kategorin. Furnizimi me veshmbathje kemi një rritje simbolike nga vitin 2015 në vitin 2016, për këtë pyeti se cilave kategori iu janë dhënë këto veshmbathje. Pastaj ai shprehu përgjëzime përsicë tha kursimin në shpenzimet përfshirë karburante ku

në vitin 2015 shpenzimet ishin në vlerë prej 67,654.77 €, kurse në vitin 2016 kemi ulje të shpenzimeve ku vlera e tyre është 51,166.85 €. Mirëmbajtja e rrugëve lokale, pyeti se për cilat rrugë bëhet fjalë, mandej mirëmbajtja e ndërtesave, për cilat ndërtesa bëhet fjalë të precizohen. Për mirëmbajtjen rutinore pyeti se çka nënkupton ky pozicion. Tek shpenzimet për dreka zyrtare kemi gjithashtu rënje që është për tu përvendetur nga 22,967.60 € sa ishin në vitin 2015, në vitin 2016 kemi 13,711.23 €, e që shprehur në përqindje i bie se kemi ulje të shpenzimeve për 67 %. Mandej paraqiti vërejtje sa i përket emërtimit të projekteve infrastrukturore, ku shumica e projekteve të realizuara mbresin të paprecizuara. Ndërtimi i rrugëve lokale në fshatrat, për cilat rrugë bëhet fjalë duhet të precizohet se për cilat rrugë bëhet fjalë, dhe pyeti se mos është menduar për rrugët që janë dërguar deri tek shtëpitë e caktuara. Pastaj ndërtimi i rrugëve në qytet përsëri nuk dihet se për cilat rrugë bëhet fjalë, andaj duhet të përcaktohen emrat e këtyre rrugëve. Projekti i ndërtimit të QMF-së në qytet duhet të precizohet se për cilën QMF bëhet fjalë cila është ajo qendër. Për ndërtimin e fushave sportive është dhënë një shumë e përgjithshme prej 13,350.00 €, kurse më poshtë këto projekte specifikohen si p.sh rehabilitimi i fushës sportive në shkollën "Anton Zako Çajupi", ndërtimi i fushës sportive në fshatin Smrekonicë, ndërtimi i fushës sportive në fshatin Lumadh dhe nëse shumëzon të gjitha këto, shuma të projekteve, atëherë shumat nuk na përputhen me shumën e dhënë më lartë, dhe kjo duhet të specifikohet dhe sqarohet.

**Muharrem Shabani, anëtar i kuvendit** – tha se duke marrë përbazë komunat tjera që raportet qoftë periodike apo financiare për to duhet të bëhet deklarimi i kuvendit në kuptimin e votimit, gjë e cila deri tanë tek ne nuk ka ndodhur. Tëciku se realizimi i buxhetit nga niveli qendror është një shifër e mirë prej 96 %, dhe shtoi se nevojitet një angazhim më i madh në rritjen e inkasimit të hyrave vetanake ku realizimin e tyre e kemi 84 %, e që i bie se jemi nën planifikim. Tek të hyrat vetanake kërkoi që të përfshihen në përpikëri borxhet nga këto të hyra që kanë mbetur nga e kaluara, më qëllim të pasqyrimit të gjendjes reale, ku këto borxhe duhet të pasqyrohen sipas viteve dhe të gjitha në përgjithësi me qëllim që këto borxhe mos të grumbullohen dhe të kemi një metodë për grumbullimin e këtyre borxheve. Mandej vlerësoi se nga raportet e kaluara tanë kemi përmirësime sa i përket shpenzimeve komunale në disa kategori, dhe apeloi që të kursejmë akoma më shumë me qëllim të uljes së shpenzimeve sidomos përmallra dhe shërbime, dhe kështu të bëhet përmirësimi i gjendjes financiare të komunës. Pastaj përsëriti se riparimi i automjeteve të komunës në vlerën prej 32,000 € dhe kjo është një shumë tepër e lartë. Shpenzimet për telefoninë fikse në vlerë prej 9,295.00 €, vërtet është një shumë e lartë, kur marrim përbazë faktin se tanë shfrytëzohet rrjeti i telefonave mobil, i cili është me ofertë pa pagesë për të gjithë shërbyesit civil dhe anëtarët e kuvendit, dhe për këtë komuna paguan një shumë prej 20,000.00 € ndaj operatorit ekonomik "Vala". Në fund tha se me një angazhim të përgjithshëm do të mund të arrihej që të kemi inkasim më të madh të hyrave vetanake, si dhe kursime apo ulje të shpenzimeve komunale.

**Safet Idrizi, anëtar i kuvendit** – fillimisht e përgëzoi ekzekutivin komunal për realizimin e buxhetit në masën prej 96 %. Si edhe herëve tjera përsëriti se paqartësitë në interpretimin e pasqyrave financiare, për ata të cilët nuk i kuptojnë të dhënat ekonomike, kishte me qenë mirë që të ofroheshin sqarime në fusnotë. Realizimi i taksës në firmë në vlerë prej 57 %, është evidente se këtë taksë e ka hequr vetë kuvendi dhe përfektet e këtij veprimi mbetet të shihet në të ardhmen. Sa i përket të hyrave vetanake, komuna jonë ka qenë e ngarkuar me 1,703,418.20 €, dhe kjo ky qenë një obligim shumë i madh për komunën, kurse realizimi ka qenë 1,422,453.41 € apo shprehur në përqindje realizimi ka qenë 84 %. Tatimi në pronë i cili është realizuar në vlerën prej 102 % dhe kjo është për t'u përvendetur. Participimi në shëndetësi 88 %, kurse në përgjithësi Drejtoria e Shëndetësisë 94 %. Duke marrë përbazë gjendjen jo të mirë sociale, planifikimi ka qenë paksa i fryrë për afro 55.000 €, por prapëserapë është një realizim i mirë. Marrë në përgjithësi kemi rritje të hyrave krahasuar me vitin e kaluar ku nga 1,383,366.55 € sa ishin në vitin 2015 në vitin 2016 kemi 1,703,418.20 €. (Për buxhetin e mbetur kërkoi sqarime nga DBF-ja). Sa i përket shpenzimeve për automjetet

komunale, vërtet shpenzimet janë të larta, për shkak të amortizimit të veturave, dhe propozoi që është mirë të mendohet që këto automjetet të qiten në ankand për shitje, dhe të blihen automjete të reja. Shpenzimet për udhëtimet jashtë vendi krasuar me vitin e kalua kemi zbritje. Mandej shpenzimet e telefonisë mobile gjithashtu janë më të ulëta. Tek mirëmbajtja e ndërtesave kërkoi sqarime se këtu a përfshihen edhe ndërtesat e shkollave dhe objekteve shëndetësore. Pastaj në mënyrë të qartë janë dhënë shpenzimet sipas drejtoreve. Shpenzimet për karburantet e veturave gjithashtu janë zvogëluar. Në fund e përgëzoi Drejtoren për Buxhet dhe Financa për të arritura që ka bërë si në kursime ashtu edhe në inkasimin e të hyrave komunale.

**Abit Abiti, ZKF-** paraqiti sqarime lidhur me reportin për të hyrat dhe shpenzimet komunale, duke u përgjigjur në pyetjet e anëtarëve të kuvendit.

**Isuf Jashari, drejtor i DBF-së** - paraqiti sqarime lidhur me reportin në fjalë, duke parashtruar të dhëna dhe statistika lidhur me të hyrat dhe shpenzimet komunale.

**Hysni Gërguri, anëtar i kuvendit** – tha se kur është fjala për lejet ndërtimore, nuk mund të kemi parashikime të sakta, përfaktin se nuk mundesh apriori ta dimë se sa leje do të lëshohen brenda një viti. Dhe përsëri pyeti se a është paraparë që të pajisen me leje ndërtimore objektet pa leje dhe nëse po në cilat lokalitete janë ato objekte

**Bajram Mulaku, Kryetar i komunës** – tha se është parimore që çdo anëtar i kuvendit, të jap propozime, sugjerime, vërejtje, por ka të drejtë edhe të kritikojë, mirëpo në rrafshin real nëse kritikat janë të arsyeshme atëherë ato shkojnë në dëm të qeverisë komunale, dhe në të kundërtën ato shkojnë në dëm të anëtarit që i bën këto kritika dhe të subjektit politik të cilin e përfaqëson. Të shtoi se për të si kryetar i komunës është shumë e rëndësishme që të bëhet realizimi i të hyrave buxhetore dhe kontrollimi i shpenzimeve. Në këtë kontekst ceku se fatmirësish të hyrat e grantit qeveritar asnjëherë deri më tanë nuk janë vu në pikëpyetje sepse ato që janë planifikuar gjithherë edhe janë realizuar, dhe kjo në të vërtet është një gjë shumë pozitive. Kurse sa i përket të hyrave vetanake atëherë ato kurrë nuk janë realizuar qind për qind, por është e vërtetë që të hyrat vetanake janë rritur vazhdimisht nëpër vite nga Ministria e Financave, andaj për këtë vit në raport me vitin e kaluar janë rritur për 36 % këto të hyra, dhe vlerësoi se nuk e di akoma se në çfarë formule janë duke u bazuar kur i rrisin këto të hyra. Në këtë relacion njoftoi se për këtë çështje ka dhënë vërejtje, e ka adresuar këtë çështje por kurrë nuk ka marrë përgjigje. Me fjalë tjera derisa vitin e kaluar kemi pasur të planifikuara të hyra vetanake 1,7000.00 €, këtë vit kemi mbi 2,3000.00€, dhe tanë komuna duhet të ballafaqohet me këtë gjendje të inkasimit të këtyre të hyrave ku shkaktohen mjaft shumë probleme në inkasim sepse gjendja ekonomike e popullatës nuk është e mirë dhe qytetarët nuk janë gjendje që të kryejnë të gjitha obligimet. Në vazhdim ai ceku se është i brengosur se si do t'i realizojë të hyrat vetanake këtë vit, kur dihet fakti se shumë projekte kapitale janë paraparë pikërisht nga këto të hyra, dhe nëse këto të hyra nuk realizohen atëherë do të jetë problem realizimi i atyre projekteve kapitale. Pastaj ceku se viteve të kaluara, disa projekte kapitale janë realizuar nga tepricat që kanë mbetur nga kontraktimi i projekteve, dhe me këtë formë janë mbuluar mungesa e të hyrave vetanake, e që beson që edhe për këtë vit nuk do të ketë probleme të kësaj natyre, por vështirësi mund të shfaqen vitin e ardhshëm. Kur bëhet fjalë për realizimin e të hyrave vetanake, ai është optimist që edhe këtë vit ato do të realizohen në tërësi, përfaktin se kah muaji mars do të aplikohet Ligji për legalizimin e objekteve, ku në komunën tonë llogariten rrëth 9,000 objekte që presin të legalizohen dhe nga ky resor priten të hyra për komunën, por të hyra priten edhe nga shpronësimi. Mandej lidhur me shpenzimet për dreka zyrtare arsyeto se është prej kryetarëve që më së paku shpenzon, dhe njoftoi se drekat janë bërë kryesisht me delegacionet që vinë nga komunat e shteteve tjera ku Komuna e Vushtrrisë ka lidhur marrëveshje për binjakëzim. Andaj lidhur me këtë arsyeto se janë shpenzuar rrëth 13,000.00€ e të cilat konsideron se kanë qenë të domosdoshme të shpenzohen. Ndërsa lidhur me shpenzimet e shtëpisë rezidenciale në Lumadh, shpenzimet e çerdhes, dhe shpenzimet tjera për raste të rënda sociale janë këto shpenzime të cilave komuna nuk mund t'i shhangemi. Ndryshtë nga kjo, shpenzimet të cilat përgjithësisht bëhen ato janë të planifikuara dhe ceku se është i thtar i

parimit që asnje "cent" mos të kthehet në buxhetin e nivelit qendror. Tutej vlerësoi se kur bëhet fjalë për shpenzimet e kontraktuara duhet sqaruar se ato janë të planifikuara si p.sh ato për pastrimin e lumbit "Tërstena", mirëmbajtja e rrugëve, dhe gjelbërimi, për këtë shpenzimet janë bërë në formën e kontraktimit në kontratë mbi vepër e cila ka rezultuar të jetë shumë e suksesshme, dhe shpenzimet kanë qenë shumë më të kontrolluara se sa përmes tenderit dhe kontraktimit të ndonjë kompanie. Pastaj lidhur me periudhën të cilën e përfshin raporti ceku se është ne rregull përfshirë faktin se edhe Zyra Ligjore e Ministrisë së Financave e ka konstatuar se në këtë formë duhet të raportohet. Lidhur me deklarimin e kuvendit përfshirë raportin përmes votimit ceku se akoma nuk e ka krejt të çartë këtë çështje, se emërtimi a duhet të jetë raport tremujor apo informatë tremujore, por njoftoi se ligjërisht kryetari i komunës raporton dy herë në vit para kuvendit një herë në gjashtëmujorin e parë dhe një herë në fundvit, dhe këto raporte aprovoohen në kuvend. Mirëpo nuk e sheh të logjikshme që përfshirë çdo tre muaj kuvendi të deklarohet përfshirë raportet e kryetarit edhe pse nuk ka siguri të plotë se si është e rregulluar me ligji kjo çështje. Në fund përfshirë emërtimin e projekteve, sidomos përfshirë infrastrukturën rrugore, ceku se është e pamundshme që çdo projekt të specifikohet, dhe shtoi se është përfshirë atë që të realizohet transparenca, në ç'rast apeloi se çdo anëtar i kuvendit ka të drejtë të kërkojë sqarime qoftë edhe në drejtoritë kompetente komunale përfshirë projektet e caktuara dhe përfshirë shpenzimin e parasë publike.

**Abit Abiti, ZKF-** paraqiti sqarime shtesë në kuptimin profesional lidhur me të hyrat dhe shpenzimet komunale, duke u përgjigjur më çështjet e ngritura nga anëtarët e kuvendit.

4.Shqyrtimi i Draft-Planit të punës së Kryetarit të Komunës;

5.Shqyrtimi i Draft-Planit të punës së kuvendit përfshirë vitin 2017 (shqyrtimi i dytë);

**Sami Istrefi, drejtor i DUMM-së -** kërkoi që nga muaji shkurt deri në maj të futen në planin e punës trajtimi i çështjeve që kanë të bëjnë me dhëni të shfrytëzim të pronës së paluajtshme komunale, kurse në muajin nëntor propozoi që të futet informata përfshirë zbatimin e planeve urbanistike në Komunën e Vushtrrisë nga Drejtoria e Urbanizimit.

**Shpëtim Zhegrova, kryesues i kuvendit** – tha se në muajin mars është paraparë të shqyrtohet raporti përfshirë situatën ekonomiko-financiare përfshirë gjashtëmujorin e parë të vitin 2017, ceku se ky me siguri duhet të jetë ndonjë gabim, dhe duhet të përmirësohet sepse fjalë është përfshirë vitin 2016. **Habib Mustafa, anëtar i kuvendit** - propozoi që në muajin mars në Planin e Punës së Kuvendit përfshirë vitin 2017 të futet si çështje përfshirë trajtimin një rregullore përfshirë mbulimin e shpenzimeve përfshirë veteranët dhe invalidët.

*Në fund të diskutimit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit në mënyrë unanimë aprovoi Planin e Punës së Kuvendit përfshirë vitin 2017 me propozimet e paraqitura nga anëtarët e kuvendit.*

6.Shqyrtimi i Propozim-vendimit përfshirë aprovimin e listës së subvencioneve përfshirë vitin 2017;

**Hysni Gërguri, anëtar i kuvendit** – tha se tek pika 2.12 e propozim-vendimit pozicioni "bashkëfinancim me donatorë", duhet të caken donatorët, tek pika 3.1 ngritja e kapaciteteve rinore trajtime-KVRL, pyeti se përfshirë trajnime bëhet fjalë dhe kush i ka kryer këtë trajnime, pika 3.7 klubet dhe shoqatat sportive, kërkoi të dijë se përfshirë cilat klube bëhet fjalë, mandjej pika 4.3 përkrahja e nxënësve dhe studentëve përfshirë aktivitatet të lira, pyeti se cilat aktivitatet janë kryer apo do të kryhen.

**Ilmi Azemi, anëtar i kuvendit** – tha se shqyrtimi i këtij propozim-vendimi në formën se si na është ofruar, është shqetësues përfshirë shumë arsyet, duke filluar nga ajo e respektimit të ligjit e deri tek propozimet përfshirë shoqata apo OJQ të përzgjedhura paraprakisht dhe pa kritere. Të tjerë pyeti se

mbi çfarë baze ligjore është mbështet drejtoria, nuk ka marrë për bazë, si dhe nuk ka zbatuar rekomandimet e KPF-së, në këtë kontekst kërkoi interpretim me shkrim në ç'rast do të determinonte saktë obligimet ligjore që kanë drejtoret komunale për zbatimin e rekomandimeve të KPF-së. Mandej tek pika 3.1 e propozim-vendimit pozicioni: ngritja e kapaciteteve rino - trajnime KVRL shuma financiare 4.500.00 €, pika 3.3 panairi i sportit ku janë propozuar 800 €, por në fakt ne nuk jemi në dijeni se nëse është mbajtur ndonjë aktivitet i tillë ndonjëherë apo jo. Pika 3.4 organizata rino dhe organizata tjera janë propozuar 3.000 €, pika 3.6 aktivitetet kulturore, rino dhe sportive vlera 5.000 € dhe këto vlera nuk janë specifikuar se për kënd janë dedikuar këto mjete, pika 3.7 klubet dhe shoqatat sportive janë propozuar 30,000.00 €, kurse vitin e kaluar për këto klube kemi pasur 35,000.00 €, dhe këtu kjo shumë është dashur të rritet dhe jo të zvogëlohet, por siç po shihet këto ndarje janë bërë sipas preferencave të dikujt tjetër. Pastaj tek pika 3.16 teatri i qytetit vlera 8,000 € edhe këtu nuk dihet se për çfarë destinimi shkojnë këto mjete. Pika 4.5 shoqata e pedagogëve të kulturës fizike shuma 500 €, për këtë vlerësoi se ne mund të formojmë për secilën lëmi shoqata dhe çfarë logjike do të kishte që të gjithave t'u ndajmë mjete financiare. Pika 4.6 OJQ "Lëvizja Koha" shuma 1.500 €, këtu paraprakisht caktohet se kush do t'i përfitojë këto mjete pa kurrfarë kriteri dhe pa i përfillur procedurat. Mandej tek pika 4.7 muaji i kulturës OJQ "Kult Studio" shuma 1.000 € edhe këtu apriori përcaktohet subjekti përfitues. Andaj lidhur me të cekurat më lart pyeti se cili ka qenë aktiviteti i këtyre shoqatave në vitin 2016, si dhe cili do të jetë aktiviteti i tyre në vitin 2017, cila është struktura organizative me emra dhe mbiemra e këtyre subjekteve përfituese të subvencioneve, statusi i tyre, a ka në këtë propozim-vendim shoqata inekzistente, a ka këtu klube apo shoqata të cilat ndoshta janë formuar vetëm sa për të përfituar subvencione nga komuna. Në fund ai propozoi që kjo pikë e rendit të ditës të shtyhet për njëren nga mbledhjet e ardhshme të kuvendit, me qëllim që ky propozim të arsyetohet dhe të plotësohet me informata plotësuese ashtu që të kemi një ndarje sa më të drejtë të këtyre subvencioneve.

**Arta Ismajli, anëtar e kuvendit** – tha se pajtohet me parafolësin e saj, dhe shtoi se është shumë skeptike me ndarjen e këtyre subvencioneve, meqenëse disa nga shoqatat kanë përfituar subvencion edhe herëve tjera nga komuna, atëherë nëse vendoset që kjo pikë e rendit të ditës të shtyhet këto subjekte duhet të ofrojnë raport finansiar për shpenzimin e mjeteve për vitin e kaluar.

**Isa Hajrizi, anëtar i kuvendit** - tha se pajtohet me propozimin e anëtarit të kuvendit z. Ilmi Azemit, dhe pyeti se në mandatin e kaluar është marrë një vendim që për ditën e ZOSH të ndahet një shumë e mjeteve financiare prej 5.000 € për organizimin e aktivitetave për nder të kësaj dite. Tësia shtoi se kjo vlerë e mjeteve është ndarë për çdo vit përjashtuar vitin e kaluar kur janë ndarë 5.000 € për hulumtim shkencor për Batalionin "Rexhep Musa". Në fund tha se kjo pikë e rendit të ditës duhet të shtyhet që të bëhet një rindarje më e drejtë.

**Habibe Gérxhaliu, anëtar e kuvendit** - pyeti lidhur me pikën 4.4 të propozim-vendimit, e cila është "java e dyreve të hapura", se çfarë aktivitetesh janë paraparë në këtë organizim.

**Ergyn Sunguri, anëtar i kuvendit** - propozoi që në ndarjen e subvencioneve për vitin 2017 të futet edhe OJQ "Qeshme" e cila është një organizatë shumë aktive humanitare, kulturore dhe propozoi që për këtë organizatë të ndahen 2.000 € subvencion.

**Melihate Basholli, anëtar e kuvendit** - tha se për aktivitetet e Drejtorisë për Kulturë duhet të ketë financim më të madh dhe më shumë aktivitete tjera, kurse tek Drejtoria për Arsim ceku se Organizata "Lëvizja Koha" për çdo vit organizon panairin e shkencës dhe kulturës dhe këtë aktivitet e vlerësoi lartë si një mundësi për pjesëmarrje të shkollave dhe nxënësve. Tësia shtoi se për të gjitha aktivitetet e organizuara duhet të ketë një specifikacion paraprak lidhur me shpenzimet që iu nevojiten, dhe në fund duhet të ofrohet raporti financiar për shpenzimet e bëra. Mandej ceku se anëtarët e kuvendit duhet të kenë më shumë informata lidhur me aktivitetet e klubeve sportive dhe shoqatave tjera. Po ashtu vlerësoi se një vëmendje duhet kushtuar teatrit të qytetit i cili duhet të ketë një fond për zhvillimin e aktivitetave të tij. Pastaj duhet pasur parasysh aktivitetin njëditor prej aktivitetit disaditor dhe konfrom këtyre të ndahen

vlera financiare për këto subjekte. Në fund tha se ne duhet të kemi specifikacionin e secilit subjekt dhe për secilin aktivitet, dhe kështu do të kishim një ndarje më të drejtë të subvencioneve.

**Zoran Rakiq, anëtar i kuvendit** - tha se kur bëhet fjalë për ndarjen e subvencioneve për vitin 2017, kishte me qenë mirë që kjo të shihet pak më detajisht se si po shpërndahen këto subvencione, për faktin se në këtë propozim-vendim nuk ka parë që është ndarë ndonjë mjet për komunitetin pakicë në Komunën e Vushtrrisë. Ne disa herë kemi kërkuar ndihmë financiare për shoqatën kulturore të komunitetit pakicë që është e regjistruar sipas ligjeve të Republikës së Kosovës. Nga Drejtoria e Kulturës, vetëm një herë është ndihmuar kjo organizatë. Kjo shoqatë kulturore i është adresuar me kërkesë Drejtorisë së Kulturës për t'i ofruar ndihmë financiare, por një gjë e tillë nuk ka ndodhur. Në fund tha se duhet të ndahen mjete financiare për secilën shoqatë kulturore të komunitetit pakicë që funksionojnë në fshatin Prelluzhë.

**Shkelzen Feka, anëtar i kuvendit** – në emër të grupit kuvendar të LDK-së kërkoi që kjo pikë e rendit të ditës të shtyhet për mbledhjen e radhës, me qëllim që e njëjtë të ndryshohet dhe të plotësohet me të dhëna tjera, si dhe propozoi që pika 3.7 mjetet financiare për klube sportive të rritet në 45.000 €.

**Habibe Gérxhaliu, anëtare e kuvendit** - tha se duhet të rritet shuma e mjeteve financiare për OJQ “ATO”, për faktin se kjo organizatë kryen një sërë aktivitetesh.

**Shpresa Rama, drejtoreshë e DKRS-së** - paraqiti sqarime lidhur me propozim-vendimin në fjalë, duke dhënë përgjigje në çështjet e ngritura nga anëtarët e kuvendit.

**Bajram Mulaku, kryetar i komunës** – tha se kishte me qenë mirë që fondi për subvencione të jetë më i madh, por siç jeni në dijeni fondi për subvencione që disa vite në mënyrë lineare ndahet në vlerën në mbi 182,000.00 €, mjete këto që nuk i plotësojnë as për së afërmë nevojat e qytetarëve. Andaj në këto rrethana është shumë e vështirë që të paraqitet një propozim i cili do t'i ndante të gjithë të kënaqur. Meqë është kështu dhe ekzistojnë dallime të mëdha ai propozoi që të formohet një komision miks mes qeverisë komunale dhe kuvendorit të komunës i cili do të merrej me hartimin e propozimit për ndarjen e subvencioneve për vitin 2017. Lidhur me zbatimin e rekomandimeve të KPF-së, sqaroi se qeveria komunale gjithherë del me një propozim dhe normalisht edhe Komiteti për Politikë dhe Financa jep rekomandimet e tij të cilat votohen në kuvend dhe në rastin konkret rekomandimet e KPF-së dhe propozimi i qeverisë dalin në votim dhe ai propozim që merr më tepër vota ai edhe aprovohet. Më tej ai vazhdoi duke sqaruar se shuma e mjeteve financiare për subvencione është tepër e vogë, kur të merren për bazë nevojat shumë të mëdha si në shëndetësi, kulturë, arsim, sport dhe resorë tjerë, andaj për ketë ai apeloi që të bëhen analiza se kah duhet t'i orientojmë këto subvencione. Në fund ai propozoi anëtarët e komisionit për ndarjen e subvencioneve nga qeveria komuna: Shpresa, Rama - drejtoreshë e DKRS-së, Musaj Tërbunja - drejtor i DA, Haki Maloku - Sekretaria e Komunës, Naim Ferizi - zyrtar në Drejtoren e Shëndetësisë.

**Habibe Gérxhaliu, anëtare e kuvendit** - propozoi për anëtar të komisionit Melihate Bashollin dhe Isa Hajrizin.

**Shkelzen Feka, anëtar i kuvendit** – në emër të grupit kuvendar të LDK-së propozoi Selvete shollën për anëtare të komisionit për ndarje të subvencioneve.

**Myrvete Hetemi, anëtare e kuvendit** - në emër të grupit kuvendar të LVV-së propozoi Mehmet Selacin për anëtar të komisionit.

**Shpëtim Zhegrova, kryesues i kuvendi** - propozoi për anëtar të komisionit, Rrahim Ajetin, Ergyn Sungjin dhe Bastri Durakun.

Në fund të diskutimit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit në mënyrë unanime vendosi me sa vijon:

1. Me këtë vendim formohet komisioni për hartimin e propozimit për ndarjen e subvencioneve për vitin 2017 në këtë përbërje:

- 1.1. Isa Hajrizi, anëtar i kuvendit (PDK);
- 1.2. Melihate Basholli, anëtare e kuvendit (PDK);
- 1.3. Selvete Sholla, anëtare e kuvendit (LDK);
- 1.4. Mehmet Selaci, anëtar i kuvendit (LVV);
- 1.5. Rrahim Ajeti, anëtar i kuvendit (AAK);
- 1.6. Ergin Sunguri, anëtar i kuvendit (KDTP);
- 1.7. Musaj Tërbunja, drejtor i Drejtorisë për Arsim;
- 1.8. Shpresa Rama, drejtoreshë e Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport;
- 1.9. Naim Ferizi, Drejtoria e Shëndetësisë;
- 1.10. Haki Maloku, Zyra e Kryetarit;
- 1.11. Bastri Duraku, Sekretaria e Kuvendit.

2. Komisioni në fjalë ka për obligim që të bëjë propozimet lidhur me subvencionet dhe të finalizojë listën përfundimtare të cilën e aprovon Kuvendi i komunës.

3. Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset komisioni i cekur në pikën 1 të këtij vendimi.

*Lidhur me propozim-vendimin për ndarjen e subvacioneve për vitin 2017, kuvendi me vota unanime aprovoi në mënyrë të pjesshme propozimin në pikat si në vijim. Pika: 1.1.1 Subvencione për raste të veçanta nga Zyra e kryetarit, pika 2.13 ndihmë për shërim Drejtoria e Shëndetësisë, pika 4.2 transporti i fëmijëve me nevoja të veçanta nga Drejtoria e Arsimit.*

1. Me këtë vendim aprovohet lista e subvacioneve për vitin 2017 sipas prioriteteve të përcaktuara me buxhetin e komunës për vitin 2017, në bazë të pozicioneve të cekura si më poshtë:

1.1 Në Zyrën e Kryetarit, subvencionet ndahen për këtë kategori:

1.1.1 Subvencione për raste të veçanta.....6,000.00 €

2. Në Drejtorinë për Arsim, subvencionet ndahen për këtë kategori:

2.1 Transporti i fëmijëve me nevoja të veçanta.....10,000.00 €

3. Në Drejtorinë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale subvencionet ndahen për këtë kategori:

3.1 Ndihmë për shërim.....16,500.00 €

3.2 Totali i subvacioneve për pozicionet e lartcekura është.....32,500.00 €

4. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Kryetari i Komunës, Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqene Sociale, Drejtoria për Arsim dhe Drejtoria për Buxhet dhe Financa.

7. Shqyrtimi i Informatës lidhur me implementimin e rekomandimeve të Auditorit të Përgjithshëm për pasqyrat financiare 2015;

**Isuf Jashari, drejtor i DBF-së - paraqiti sqarime hyrëse lidhur me informatën që ka të bëjë me implementimin e rekomandimeve të Auditorit të Përgjithshëm për pasqyrat financiare për vitin 2015.**

**Muharrem Shabani, anëtar i kuvendit** – tha se është në interesin tonë të përgjithshëm, që të gjitha ato të gjetura nga ana e auditorit të përgjithshëm, të mos përsëriten në të ardhmen, që të mos shkaktohen rreziqe në dëmtimin e buxhetit komunal dhe taksave të qytetarëve. Andaj lidhur me këtë kërkoi që të kemi angazhim të përgjithshëm, që të adresohen dhe të zbatohen të gjitha rekomandimet e auditorit të përgjithshëm, dhe në fund të ofrohet një raport para kuvendit lidhur me implementimin e këtyre rekomandimeve. Një çeshtje tjetër mjaft me peshë që duhet të adresohet është çeshtja e regjistrimit të pronës komunale, e cila ligjërisht duhet të verifikohet me 1/3 e saj brenda vitit kalendarik. Tutje shtoi se në të kaluarën sikur kemi dështuar në këtë segment por tani e tutje duhet të angazhohemi që kjo çeshtje të përfundohet duke u kryer verifikimi i pronës komunale e cila është një burim i rregullt i të hyrave komunale.

**Shpëtim Zhegrova, kryesues i kuvendit** – tha se me qëllim të adresimit sa më të mirë të rekomandimeve është mirë që të kemi komisionin për implementimin e rekomandimeve të auditorit të përgjithshëm.

Për këtë komision kuvendit i propozoi këta anëtarë:

Ilmi Azemi, anëtar i kuvendit;  
Muharrem Shabani, anëtar i kuvendit;  
Agron Perçuku, anëtar i kuvendit.

8. Shqyrtimi i Draft-Planit të veprimit për përmirësimin e shërbimit-Mobiliteti në trafik 2017-2019;

**Hysni Gërguri, anëtar i kuvendit** – tha se para disa muajve e kishte shtruar nevojën e vendosjes së një semafori në rrugën që çon tek varrezat, gjë e cila është shumë e nevojshme. Dhe materiali që është dërguar për këtë plan nuk shihet se ky projekt do të përfundohet. Në fund tha se vendoja e këtij semafori është e domosdoshme sepse në atë vend krijuhen tollovi dhe në këtë formë rrezikohet jeta e qytetarëve.

**Dibran Përçuku, nënkyetar i komunës** – tha se në kuadër të një projekti i cili veç se është duke u zhvilluar do të bëhet rregullimi, zgjerimi dhe do të ndërtohet trotuari, si dhe staza për biciklistë, kurse tek marketi “Emona” do të ndërtohet një rrëthrrrotullim, deri tek semaforët e rrugës “2 Maji”, andaj ky semafor do të trajtohet në kuadër të këtij projekti.

**Isalm Latifi, zyrtar i DSHP-së** - paraqiti sqarime lidhur me draft-planin në fjalë dhe dha përgjigje në temat e ngritura nga anëtarët e kuvendit.

Në fund të diskutimit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit në mënyrë unanime vendosi me sa vijon:

1. Jepet në diskutim publik Draft-Plani i Veprimit për Përmirësimin e Shërbimit Mobiliteti në Trafik 2017-2019.

2. Diskutimi publik fillon nga data 01 shkurt 2017 dhe zgjat deri më 15 shkurt 2017.

3. Obligohet Zyra Komunale për Informim që të ndërmerr masa për informim të qytetarëve lidhur me diskutimin publik, konform dispozitave të Udhëzimit Administrativ për Transparencën në Komuna, dhe konform nenit 9.2 dhe 9.4 të Rregullores për Transparencë 01 Nr.99/13, dt. 25.04.2013.

4. Obligohet Drejtoria për Shërbime Publike (DSHP-ja) që si hartues dhe propozues i Draft-Planit në fjalë të organizojë diskutim publik konform Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr.

01/2015 për Transparencë në Komuna dhe nenit 9.5 të Rregullores për Transparencë 01 Nr.99/13, dt. 25.04.2013.

Gjithashtu DSHP-ja obligohet që vërejtjet eventuale, sugjerimet apo propozimet për ndryshime t'ia prezantojë Kuvendit të Komunës në rastin e shqyrtimit të dytë të Draft-Planit në fjalë në mbledhjen e KK-së në muajin shkurt 2017.

9. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për ndihmë financiare nga fondi për transfere dhe subvencione;

**Musaj Tërbunja drejtor i DA-së - paraqiti sqarime hyrëse lidhur me propozim-vendimin në fjalë duke shtuar se bëhet fjalë për financimin e shpenzimeve të udhëtimit për një nxënës me nevoja të veçanta.**

**Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit në mënyrë “unanime” vendosi me sa vijon:**

1. Me këtë vendim ndahen mjete financiare në vlerë prej **990.00 €** (nëntëqind e nëntëdhjetë euro) për **Delfina Maqastena**, (është fëmijë me nevoja të veçanta), e regjistruar në vitin shkollor 2016/17 në shkollën speciale për të verbër-QBMK „Xheladin Deda” në Pejë, e cila trajtohet profesionalisht në aspektin teflopedagogjik-psikologjik dhe punë edukative sipas fushave të aktiviteteve.

2. Këto mjete ndahen me qëllim të mbulimit të shpenzimeve të transportit, për Delfina Maqastena dhe shoqëruesin e saj të cilët udhëtojnë dy herë në javë në relacionin Vushtrri-Pejë dhe anasjelltas.

3. Shuma e mjeteve të cekura në pikën 1 të këtij vendimi, ndahen nga kategoria e subvencioneve dhe transfereve, dhe kjo shumë ndahet në emër të Sabrije Maqastenës nëna e të lartcekurës, për shkak se e njëjtë është e moshës së mitur.

4. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Kryetari i Komunës, Drejtoria për Arsim dhe Drejtoria për Buxhet dhe Financa.

10. Shqyrtimi i Raportit vjetor për punën e Komitetit për Komunitete;

11. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për emërimin e anëtarëve të Komitetit Konsultativ për Persona me Nevoja të Veçanta;

**Habib Mustafa, anëtar i kuvendit** - njoftoi se komisioni ka intervistuar kandidatët konkurrent, në Komitetin Konsultativ për Persona me Nevoja të Veçanta, dhe ka finalizuar listën me kandidatë, të cilët kanë qenë më të suksesshëm, si dhe i ka ofruar kuvendit propozimin për aprovim.

**Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit në mënyrë “unanime” vendosi me sa vijon:**

1. Me këtë vendim emërohen anëtarët e Komitetit Konsultativ për Persona me Nevoja të Veçanta, në këtë përbërje:

- 1.1 Isak Hyseni,
- 1.2 Fatlum Maloku,
- 1.3 Edmond Krasniqi,

- 1.4 Arbian Gérxhaliu,
- 1.5 Blertë Behrami,
- 1.6 Edvin Makiqi,
- 1.7 Sevdije Zymeri.

2. Komiteti Konsultativ në përbërje të cekur si në pikën paraprake do t'i ushtrojë kompetencat dhe funksionin e tij konform dispozitave të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, Statutin e Komunës, Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr.01/2016 për Procedurën e Themelimit, Organizimin dhe Kompetencat e Komitetetve Konsultative në Komuna.

3. Komiteti Konsultativ në fjalë, në mbledhjen e parë të tij do të emërojë Kryesuesin dhe zv.kryesuesin, për të udhëhequr mbledhjet e komitetit.

4. Mandati i anëtarëve të Komitetit Konsultativ për Persona me Nevoja të Veçanta do të jetë katërvjeçar (4) konform Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr.01/2016 për Procedurën e Themelimit, Organizimin dhe Kompetencat e Komitetetve Konsultative në Komuna.

5. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Komiteti Konsultativ për Drejtat e Njeriut dhe Barazi Gjinore, Kryesuesi dhe Sekretaria e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë.

## 12.Të ndryshme

a). Shqyrtimi i Propozim-vendimit, për ofrimin e ndihmës financiare për shërim për Kujtim Saraçin;

**Xhevahire Selmani, anëtar e kuvendit** - paraqiti një ekspoze lidhur me jetën dhe veprën e luftëtarit të UÇK-së Kujtim Saraçi, si dhe foli për gjendjen e rëndë shëndetësore të tij, i cili pas plagëve të marra në luftë gjendjen shëndetësore e ka mjaft të rënduar. Për këtë ajo propozoi që për nevojat e tij për shërim, ku duhet ta kryejë një operacion jashtë vendit, propozoi që kuvendi t'i ndajë një shumë financiare prej 5525 €.

**Isa Hajrizi, anëtar i kuvendit** – tha se e përkrah mendimin e parafolëses dhe shtoi se Kujtimin e njeh edhe gjatë luftës, por i di problemet e tij shëndetësore pas luftës, i cili deri në vitin 2002 ka qenë në Gardën e TMK-së, dhe me këtë njoftoi se ka pasur disa intervenime kirurgjike, për heqjen nga turpi të copave të predhës që i ka marrë nga plagët në luftë. Andaj propozoi që kjo shumë e mjeteve financiare për shërim t'i ndahet nga ana e kuvendit.

**Mehmet Selaci, anëtar i kuvendit** – tha se e përkrah propozimin, që Kujtim Saraçit t'i mundësohet mbulimi i shpenzimeve për operacionin që duhet ta bëjë jashtë shtetit, pasi gjendja e tij shëndetësore nuk është e mirë.

**Habib Mustafa, anëtar i kuvendit** - tha se e përkrah propozimin që t'i dilet në ndihmë Kujtim Saraçit, pasi gjendja e tij shëndetësore është e rëndë, dhe tanë veç sa i është përkeqësuar gjendja.

Në fund të diskutimit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit në mënyrë unanime vendosi me sa vijon:

1.Me këtë vendim lejohen mjete financiare nga buxheti i komunës-fondi për subvencione dhe transfere, pozicioni “Ndihmë për Shërim” në Drejtorinë e Shëndetësisë për Kujtim Saraçin, me banim në fshatin Bivolak të Komunës së Vushtrrisë, në shumën prej 5525 € (pesë mijë e pesëqind e njëzet e pesë euro).

2.Shuma e cekur në nenin 1 të këtij vendimi ndahet me qëllim të shërimit të tij.

3. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Drejtoria për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale dhe Drejtoria për Buxhet dhe Financa.

b). Shqyrtimi i Propozim-vendimit, për ofrimin e ndihmës financiare për shërim për Veton Rrahmanin;

**Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit në mënyrë “unanime” vendosi me sa vijon:**

1.Me këtë vendim lejohen mjete financiare për Veton Rrahmanin, me banim në fshatin Kollë të Komunës së Vushtrrisë, nga buxheti i komunës-fondi për subvencione pozicioni “Ndihmë për Shërim” në Drejtorinë e Shëndetësisë në shumën prej 1000 € (një mijë euro).

2.Shuma e cekur në nenin 1 të këtij vendimi ndahet me qëllim të shërimit të tij.

3.Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Drejtoria për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale dhe Drejtoria për Buxhet dhe Financa.

c). Shqyrtimi i Propozim-vendimit, për lejimin e mjeteve financiare nga subvencionet dhe transferet për Qendrën për Mbrojtjen e Gruas dhe Fëmijës “Raba Voca”.

**Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit në mënyrë “unanime” vendosi me sa vijon:**

1.Me këtë vendim, Qendrës për Mbrojtjen e Gruas dhe Fëmijës “Raba Voca” në Mitrovicë, i lejohen mjete financiare në shumë prej 1500.00 € (një mijë e pesëqind euro), nga buxheti i Zyrës së Kryetarit të Komunës, subvencione dhe transfere – subvencione për raste të veçanta, për shpenzime të krijuara gjatë vitit 2017.

2.Autorizohet Kryetari i Komunës që të lidhë marrëveshje me përfituesin e këtyre mjeteve konform legjislacionit të zbatueshëm.

3.Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Drejtoria për Buxhet dhe Financa dhe Zyra e Kryetarit të Komunës.

**Mbledhja përfundoi në orën 13:45.**

Bastri Duraku

Procesmbajtës

Shpëtim Zhegrova

Kryesues i Kuvendit

